

VENDIM
Nr. 36, datë 1.2.2013

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN PRIVAT KABLLOR
“TV NEXT KABËLL”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, miratuar me vendimin nr. 221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010, vendimit të KKRT-së, nr. 160, datë 30.11.2012 “Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë radiotelevizivë kabllorë”, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit për t’u licencuar si operator privat kabllor dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë licencë subjektit fizik, z. Ervis Beqiri, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për “TV Next Kabëll”, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal bashkinë Kamëz.
 2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen: struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endirë Bushati